

A dëshiron të zhvillosh vetitë e tua kreative?

A dëshiron të marrësh hapin e parë kundrejt një profesion artistik?

A dëshiron të vazhdosh studimet pas gjimnazit?

A dëshiron të thellësohesh në diçka që është me rëndësi për ty?

A dëshiron të mësosh më tepër në lidhje me vlerat e artit dhe të kulturës tek ne njerëzit?

Në atë rast Programi estetik mund të jetë për ty.

Te Programi estetik do të jepet mundësia të përjetosh dhe të mësosh se si të analizosh artin dhe kulturën. Do të mundesh t'i zhvillosh vetitë e tua kreative. Ndoshta do të ndërmarrësh një hap të madh përpara në një lëmi që është me rëndësi për ty. Por është mirë që të kujtohet se Programi estetik paraprakisht është një bazë për vazhdim të studimeve. Vetëm një e treta e nxënësve vazhdojnë të punojnë me art dhe kulturë. Prap se prap, nxënësit janë të mendimit se programi ka qenë një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të tyre personal.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse je i interesuar që të punosh me art dhe kulturë në ardhmëri, do të duhet të jeshë i gatshëm që të vazhdosh studimeet pas gjimnazit. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se cilat kurse do të duhet t'i mësosh që të jesh me kompetencë për të kërkuar në kualifikimin që e do ndjekësh.

Mund poashtu edhe të vazhdosh studimet edhe në lëmi të tjera përveç atyre që janë artistike dhe kulturore. Përgatitu duke i zgjedhur ato kurse gjimnaziale me të cilat do të mund të kërkojë kualifikime pas gjimnazit.

Punë ku mund të pranohesh

Shembull i punëve me drejtim estetik është formues grafik, dizanjer industrial, arkitekt mobilimesh, mësues, pedagog vallëzimi, terapeut vallëzimi, koreograf, teknik i zërit, muzikant i kishave, pedagog dramash ose scenograf. Që të mund t'i kërkojë këto punë do të duhet t'i vazhdosh studimet pas gjimnazit.

Përmbajtja e Programit

Programi estetik përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurse e tjera janë veçanta për Programmin estetik. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej katër drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin elektrik në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimet. Në disa vende mund të ketë edhe me tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Drejtimet kombëtare janë:

- Imazh dhe krijim formash – të jep dituri të gjëra dhe themelore në lëminë e imazheve dhe të krijimit të formave, por të lejon njëkohësisht që të fokusohesh në një drejtim të veçantë ose një material të veçantë
- Vallëzim – të krijon kuptim për vallëzimin në tërësi përmes ushtrimeve, krijimeve dhe teorisë
- Teatër – të jep dituri të gjëra për lëminë e teatrit por të lejon që njëkohësisht të thellohesh në për shembull aktrim.

Kontake me tregun e punës

Te Programi estetik nuk do të kesh kualifikim në vende të punës (APU), por mund të ndodh që gjatë disa kurseve të vizitosh një apo disa vende pune. Kjo varret nga drejtimi që e ke zgjedhur dhe nga kurset që i ke zgjedhur, por interesimin yt dhe kontaktet mund të ndikojnë poashtu.

Ardhmëri dhe punë

Mund të jetë e vështirë që të gjejsh një punë artistike ose me drejtim kulturor, edhe nëse i vazhdon studimeet pas gjimnazit. Papunësia tek profesionet estetike janë nga më të lartat te tregu i punë. Por gjatë kohë te Programi estetik do të jepet mundësia që të zhvillosh kreativitetin tënd dhe që të forëcosh vetëvlerësismin. Këto mund t'i marrësh me vete pavarësisht se ku do të punosh në ardhmëri.